



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

PROJEKT - VENDIM

Nr.08, datë 03.10.2018

PËR

MIRATIMIN E NDRYSHIMEVE NË PROJEKT GJATË NDËRTIMIT PËR OBJEKTIN:
“REHABILITIMI I “TEATRIT KOMBËTAR TË OPERAS DHE BALETIT DHE
ANSAMBLIT POPULLOR” (ZHVENDOSJA E AMBIENTIT TEKNIK MEKANIK DHE
GJENERATORIT)

Në mbështetje të neneve 27, 28, dhe 48 të Ligjit Nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar, nenit 17, të Vendimit Nr. 408, datë 13.05.2015 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, si dhe Vendimit Nr. 519, datë 20.09.2017 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit”, i ndryshuar, me propozim të Ministrisë së Kulturës, Këshilli Kombëtar i Territorit,

VENDOSI:

1. Miratimin e ndryshimeve në projekt gjatë ndërtimit për objektin: “Rehabilitimi i “Teatrit Kombëtar të Operas dhe Baletit dhe Ansamblit Popullor” (Zhvendosja e ambientit teknik mekanik dhe gjeneratorit), me subjekt zhvillues Ministrinë e Kulturës.
2. Harta e Planvendosjes së Strukturave, miratuar me vendimin e Këshillit Kombëtar të Territorit Nr.6, datë 28.07.2016, zëvendësohet me Hartën e Planvendosjes së Strukturave bashkëlidhur këtij vendimi.
3. Ngarkohet Agjencia e Zhvillimit të Territorit në bashkëpunim me Ministrinë Kulturës për zbatimin e këtij vendimi.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

EDI RAMA

MINISTËR I LINJËS

MINISTËR I KULTURËS

MIRELA KUMBARO

ANËTAR / SEKRETAR I KKT

DREJTOR I AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT

LEDIA TOTA